



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIQ-OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËR
UPRAVA DPËSTE ADMINISTRATIVE

Dalës-kilazma

Nr.
Gr.

1-92

Data
Datum

02.06.2019

OBILIĆ-OBILIĆ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, kërkesa e MAPL-së (VI-020-370/10, dt.23.04.2019) Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.30.5.2019, mori këtë:

V E N D I M

1. Të mbetet në fuqi vendimi nr.I-50, i dt.03.04.2019 për kërkesën nga Shoqata sindikale e Administratës Komunale Obiliq, që të ndahen mjetet në vlerën prej 3,000.00 €.
2. Mjetet financiare merren nga kategoria e subvencioneve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.


T'i dërgohet

- Kryetarit
- Kryesuesit
- Nënkryetarit
- MAPL
- Drejtorië së Ad.
- DEFZH
- Anëtarëve të KK
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 18.04.2019
Nr. 020-370/5

Për: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit
Burim Gerguri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit

Lënda: Shkresë përcjellëse

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar Vendimin Nr.1-50 për aprovimin e kërkesës nga Shoqata Sindikale e administratës komunale Obiliq për ndarjen e mjeteve, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit dhe nënshkruar nga Kryesuesi i KK të Obiliqit, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Duke u bazuar në nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2016 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me datë 12.04.2019, ka përcjellë aktin e lartshënuar për vlerësim të ligjshmërisë në MF.

MAPL, kërkon nga Komuna që zyrtarisht të njoftohet lidhur me ndërmarrjen e veprimeve konkrete për rishqyrtimin e këtij akti.


Bashkangjitur gjeni Raportin nga MF lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë.

Me respekt,

Rozafa Ukimeraj

Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së

Kopje: Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

DATËJA:	17.04.2019
REFERENCË:	071/2019
PËRZATO:	Rozata Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAF-së
PËRMESTPREKO/THROUGH:	Naim Baftiu, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave
NGA/OD/FROM:	Komisioni për mbikëqyrjen e përshatshmërisë të aktive të Komunave: 1. Bahrije Berisha - Kryesuese; 2. Lumije Hetemi - Anëtare; 3. Jak Ndrocaj - Anëtar; 4. Imer Rudari - Anëtar; 5. Arta Vehapi - Anëtare.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i Vendimit Nr.1-50, për aprovimin e kërkesës nga Shoqata Sindikale e administratës komunale Obiliq për ndarjen e mjeteve

U nderuara znj. Ukimeraj,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Aktëve të Komunave dhe Vendimit Nr. 88/2016 të dt. 15.06.2016 Komisioni për Vlerësimin e Ligjshmërisë së Aktëve të Komunave, në shikim të prurur, me datë 12.04.2019 me Nr. Protokollit 525-1, të Vendimit Nr.1-50, për aprovimin e kërkesës nga Shoqata Sindikale e administratës komunale Obiliq për ndarjen e mjeteve në vlerë prej 3.000 euro, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit dhe nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Obiliqit për vlerësim të ligjshmërisë.

Komisioni pas vlerësimit të përshatshmërisë në bazë të nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Aktëve të Komunave, ka shqyrtuar vendimin e lartëkor, dhe në konsultim me analisten e Buxhetit Komunal për këtë komunë, vlerëson se ky vendim nuk mund të prodhojë efektë juridike për arsye se nuk jenë bazuar në rregulloren e brendshme për subvencione me Nr. 108 të datës 28.11.2016 neni 2 dhe neni 5, të komunës suaj.

Me respekt,